



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 617/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Milifar” sh.p.k, në procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt “Blerje të medikamenteve dhe mjeteve mjekësore veterinare”, me nr. REF-68019-05-09-2018, me fond limit 17,500,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.06.2018, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Vetefarm-Jugu” sh.p.k, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Milifar” sh.p.k
Adresa: Rr. “Xh. Martini”, 33, Tiranë.

Autoriteti kontraktor:

Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit
Adresa: Rr. “Abdi Toptani”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 10.05.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt “Blerje të medikamenteve dhe mjeteve mjekësore veterinare”, me nr. REF-68019-05-09-2018, me fond limit 17,500,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.06.2018, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

II.2 Në datën 25.06.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 26.06.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. "Milifar" shpk,	14,747,580 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
2. "Kristaq Skënderi" pf	16,798,303 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
3. "ALMedikal" & "Anipharma" shpk	17,150,000 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
4. "Vetëfarm-Jugu" shpk	17,399,000 lekë pa tvsh	Kualifikuar;

II.4. Nga verifikimet e kryera, rezultoi se operatori ekonomik "Milifar" sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyen si më poshtë vijon:

"• Operatori ekonomik në të njëjtin orar me hapjen e ofertave (ora 11:00) dorëzoi 42 (dyzetë e dy) nga 43 (dyzetë e tre) mostrat e kërkuara referuar procesverbalit Nr. 1256 prot., datë 25.06.2018. Në shtojcën 10 "Specifikimet teknike" të Dokumentave Standarte të Tenderit është specifikuar se: "Data e skadencës në ditën e dorëzimit të mostrave duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit". Nga kontrolli i mostrave rezultoi se:

- Artikulli Nr.7 Amoxicilinë La 100 ml ka afat përdorimi deri në Maj 2019.

- Artikulli Nr.18 Suture USP Nr.1 PGA+age ka afat përdorimi deri në Prill 2019.

- Për artikullin Nr.12 Spray Postoperator oxytetraciline 3.58% 140 gr, janë sjellë 3 (tre) mostra prej të cilave asnjëra nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara. Dy nga mostrat janë me përqëndrim 2% dhe tjetra 1.78 %.

- Për artikullin Nr.25 Përparëse operimi një përdorimshe, mostra e sjellë është përparëse e zakonshme pune dhe jo e përshtatshme për sallë operimi.

- Për artikullin Nr.42 Shtroje për qentë, mostra e sjellë është tapet për përdorim shtëpiak dhe jo sipas specifikimit të kërkuar.

- Për artikullin Nr.43 Ushqim për qen, mostra e sjellë nuk është e plotë pasi është paraqitur vetëm ambalazhi dhe produkti më vete në qese plastike, duke mos vërtetuar vërtetësinë e mostrës.

- Artikulli Nr. 28 Lak special për kapjen e qenve nuk është paraqitur, mungon."

II.5. Në datën 02.07.2018 operatori ekonomik ankimues "Milifar" sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe duke ngritur pretendime mbi ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik "Vetëfarm-Jugu" sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1332/2 Prot. datë 04.07.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Milifar" sh.p.k., duke mospranuar pretendimet e ngritura në ankesë.

II.7.Në datën 13.07.2018 operatori ekonomik ankimues “Milifar” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Arsyet e skualifikimit të Kompanisë janë shumë absurd edhe të pavetëta dhe të pambeshtetura në fakte reale dhe teknike për mostrat që në kemi sjelle. Jam skualifikuar me pretextin se:

1.Nuk kam sjelle mostrën e lakut për kapjen e qenve:

Une në këto raste kam paraqitur katalogun e një kompanie me të mirë në bote për prodhimin e këtij produkti, dhe mallin do ta sillja sipas karakteristikave që une kam paraqitur.

2.Data e skadencës për produktin Amoxicillin L.A.

Në kemi paraqitur një produkt me skadencë fundi i muajit Maj 2019.Tenderi u bë në Qersher 2018 ku po të llogaritet në jemi korrekt me kriterin e skadencës 1 vit. Megjithatë duhet theksuar se këto janë mostra dhe nuk duhet të konsiderohet data e skadencës si kriter skualifikimi. Këto merren si kriter për vlerësim për të mbuluar vlerësimin jo të drejtë që kanë marrë.

3.Për përmbajtjen e Produktit Spray post operator Oxytetracyclin 3.58 %. Ky produkt nuk ekziston në treg. Nuk është 3.58 % por përmban në 140 gram masën 3.58 gr oxytetracyclin. Në kemi paraqitur produktin që përmban 4 gram oxiteracyclin jo 3.58 gram, pra me shumë. Duam të theksojmë se kompania Fituse nuk e ka paraqitur këtë mostër produkti fare se është I skaduar dhe nuk është për momentin në tregun e shitjes.

4.Skadencia e produktit Suture UPS.

Në dokumentat teknike të tenderit është kërkuar vetëm Skadencia e medikamenteve veterinarë. Dua të theksoj se ky produkt nuk është medikament Veterinar. Pra nuk është kërkuar skadencia e këtij produkti. Me vjen keq dhe për specialistet e bashkisë që nuk I kanë sqaruar komisionerët e tenderit nga ana teknike.

5.Për artikullin Perparse operimi një përdorim.

Në kemi paraqitur një produkt me standarte të BE që përdoret në sallat e operacionit dhe për njëzëz. Cuditë nga ky vlerësim I komisionit. E kundërshtoj këto arsye. Është malli I duhur që kërkohet.

6.Shtrojsa për të qëndruar qente.

Në kemi paraqitur një produkt shumë cilësor ku qeni të qëndrojnë në kafaz në një mbulesë të rehatshme, higjienike dhe me sipërfaqe të bollshme. Nuk e di se çfarë mbulesë kërkohet ku në dokumentat e tenderit si për të gjithë produktet dhe për këtë produkt nuk janë përcaktuar specifikimet teknike të mallrave që kërkohen.

7.Për ushqimin e Qeneve.

Në kemi paraqitur paketimin dhe mostra konform rregullave për përmbajtjen, racionin ushqimor, skadencën etj. Ky ushqim është shumë cilësor dhe me Origjin Gjermane.

Ashtu sikur ju thashë me sipër arsyt e skualifikimit të kompanisë Milifar nuk qëndrojnë në fakt, por janë thjeshtë pretekste për të shpallur një kompani tjetër për arsye përfitimi

korruptive. Dua te theksoj qe kur u moren mostrat ne dorzim nga komisjoni jane marre vetem si fizik pa u kontrolluar dhe treguar se cfar jane konkretisht permbajtja skadencia etj. Mostrat e kompanis fituse nuk jane pare fare per asnje kriter por jane pare vetem mostrat tona me tendence. JU LUTEMI VERIFIKOJINI MOSTRAT E SUBJEKTIT FITUES.[...]”

II.8.Në datën 23.07.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1498/1prot., datë 23.07.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Milifar” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “- Artikulli Nr. 28 Lak special për kapjen e qenve nuk është paraqitur, mungon.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën 9, pika 2.3.2, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: “**2.3.2. Në datën dhe orën e hapjes së procedurës ofertuesit duhet të paraqesin mostra për artikujt e tabelës së mëposhtme, pranë sekretarisë së Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave të procedurës “Blerje të medikamenteve dhe mjeteve mjekësore veterinare”. Data e skadencës për medikamentet në ditën e dorëzimit të mostrave të jetë jo më pak se 1 (një) vit.**

Nr	Emërtimi	Njësia
1	<i>Shiringa 20cc ml +age</i>	<i>copë</i>
2	<i>Shiringa 50 cc ml+age</i>	<i>copë</i>
3	<i>Vaksina Tërbimi 2 UI shtami Pasteur RIV</i>	<i>fl</i>
4	<i>Vigona Ngjyrë Blu</i>	<i>copë</i>
5	<i>Xilazinë 50 ml</i>	<i>fl</i>
6	<i>Ketaminë 50 ml</i>	<i>fl</i>
7	<i>Amoxicilinë La 100 ml</i>	<i>fl</i>
8	<i>Ivermectinë 100 ml</i>	<i>fl</i>
9	<i>Lincospectinë 100 ml</i>	<i>fl</i>
10	<i>Betadinë</i>	<i>ml</i>

11	Alkool	ml
12	Spray Postoperator oxytetraciline 3.58% 140 gr	fl
13	Ujë i oxigjenuar	ml
14	Serume Ringer 500 ml	copë
15	Serume Glukoze 10 % 500 ml	copë
16	Doreza Sterile Nr.6 Nr.8	copë
17	Doreza jo Sterile Nr.6 Nr.8	copë
18	Suture USP Nr.1 PGA+age	copë
19	Bisturi Nr.21	copë
20	Garza Sterile 10*10 cm	copë
21	Mbulesa një përdorim sterile	copë
22	Rapid test Leishmania	test
23	Matrikuj 30 mm rrethor	copë
24	Leokoplast 1.25 cm*5 m	copë
25	Përparëse operimi një përdorimshe	copë
26	Doreza për kapjen e qenve	copë
27	Maska për qen (masa M-L)	copë
28	Lak special për kapjen e qeneve	copë
29	Zinxhir qafe	copë
30	Çizme Llastiku	copë
31	Ketaxyl 30 ml	fl
32	Mushama Shiu me kapuç	copë
33	Vaksinë DHP+Lepto	copë
34	Fipronil 10-25 kg	copë
35	Dexametazon 50 ml	fl
36	Enrofloxacinë 10% 100 ml	fl
37	Qese 1 m * 70 cm	kg
38	Maska operacioni një përdorimëshe	copë
39	Pinca Hemostatike	copë
40	Pinceta me dhëmbë	copë
41	Tasa ushqimi	copë
42	Shtroje për qentë	copë
43	Ushqim për qen	kg

”

III.1.2.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni,

vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.3. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nëpërmjet informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, në proces-verbalin nr.1256prot., datë 25.06.2018, i cili është nënshkruar edhe nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankimues “Milifar” sh.p.k., është pasqyruar se ky i fundit ka paraqitur 42 nga 43 prej mostrave të kërkuara në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi nga autoriteti kontraktor, mbi artikujt e objekt prokurimi. Nga verifikimi i mostrave të administruara pranë KPP, konstatohet se nuk është paraqitur nga ankimuesi mostra e artikullit “*Lak special për kapjen e qenëve*”. Ky fakt është pranuar edhe nga vetë operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur prej tij pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, me pretendimin se ka paraqitur katalog të këtij artikulli.

III.1.6. KPP gjykon se kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat

dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentat e tenderit përbën shkak për skualifikim. Komisioni thekson se autoriteti kontraktor ka kërkuar në mënyrë eksplicite paraqitjen e mostrave fizike për çdo artikull të kërkuar dhe nuk e ka lënë në asnjë rast të hapur mundësinë për të paraqitur katalog të artikullit në mungesë të mostrës fizike. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara, për vënien në funksion të tyre. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 9, pika 2.3.2, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. KPP gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Milifar” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues ”Milifar” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Vetëfarm-Jugu” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.3.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.3.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislati janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërisht nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të mërren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Milifar” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Blerje të medikamenteve dhe mjeteve mjekësore veterinare*”, me nr. *REF-68019-05-09-2018*, me fond limit *17,500,000* lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën *25.06.2018*, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1258 protokoli Datë 13.07.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

